

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, (e vendosur në objektin e degës së kësaj gjykate në Vushtrri) si kontestimore e përberë nga gjyqtari individual Faton Ademi, ne qështjen juridike të ish-paditësit: _____, tani trashëgimtarit të tij _____ të cilin e përfaqëson sipas autorizimit me shkrim Av. _____ kundër të paditurës: Komuna e _____ Drejtoria Komunale e Arsimiti te përfaqësuar nga avokati publik komunal _____, për pagesën e të ardhurave personale, pagave jubilarë dhe pagave përcjellëse, pas mbajtjes së seancës kryesore të datës: 22.08.2013 me prezencën e palëve ndërgjyqëse, me datën: 16.09.2013 bie këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET kërkesëpadia e paditësit _____ si trashëgimtar i ish paditësit _____ kundër të paditurës Komuna e _____-Drejtoria Komunale për Arsim, për pagesën e të ardhurave personale, pagave përcjellëse dhe shpërblimit jubilar si e **PA BAZUAR**

Secila palë i bartë shpenzimet e vetë procedurale

A r s y e t i m

Paditësi _____ me datën: 05.07.2012 ka parashtruar padi në gjykatë kundër të paditurës për pagesën e të ardhurave personale, pagave përcjellëse dhe shpërblimit jubilar. Me datën: 01.07.2013 trashëgimtari i paditësit përmes parashtresës njofton gjykatën se pas vdekjes së paditësit ai e vazhdon procedurën sipas lëndës në fjalë, ndërsa si provë i dorëzon gjyaktës edhe aktvendimin mbi trashëgimin të përpiluar në zyrën noteriale.

Përfaqësuesi i të paditurës deklaroi se e kundërshton padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit ngase kërkesat sipas kërkspadisë nuk janë të rregulluara dhe të përcaktuara me asnjë dispozitë imperative as ligjore e as të akteve tjera normative që ta obligonin punëdhënësin për kompenzimin e natyrës së tillë.

Në fjalën përfundimtare pala paditëse dhe ajo e paditur mbeten në pozicionet e tyre të kundërta siq ishin në fillim të seancës.

Gjykata ne shqyrtimin kryesor i administroi këto prova: kërkesa e dt.08.12.2011, vendimi mbi pushimin e marrëdhënies së punës i dt.17.05.2011, kontrata e punës e paditësit dt.28.09.2010, parashtresa e paditësit e dt.01.07.2013, certifikata e vdekjes së paditësit e dt. Së lëshimit 12.06.2013, aktvendimi mbi trashëgiminë i dt.04.10.2012,

vërtetimi i dt.29.10.2010, vërtetimi i dt.07.12.2011, vërtetimi mbi përvojën e punës lëshuar nga departamenti i administratës pensionale, vështirimi në librezën e punës me numër të rexhistrimit 16027.

Pas analizimit dhe çmuarjes së provave të cekura një nga një dhe të gjitha së bashku si dhe rezultatit të kësaj procedurës, është përcaktuar me nenin 8 të LPK, gjykata vlerësoi se në mes të palëve procedurale nuk janë kontestuese këto fakte:

Se paditësi ka qenë në marrëdhënie pune të e paditura pasi një gjë e tillë vërtëtohet si nga kontrata e punës e lidhur në mes të paditësit dhe të paditurës, pastaj nga vërtetimi mbi përvojën e punës, librezat e punës.

Se paditësi ka punuar së fundi në shkollën e mesme të lartë teknike " " në , pasi një gjë e tillë vërtëtohet në bazë të kontratës së punës dhe vërtetimit të lëshuar nga sekretari i shkollës.

Se paditësit marrëdhënia e punës i është pushuar me arritjen e moshës së pleqërisë moshës 65 vjeçare, pasi një gjë e tillë vërtëtohet nga vendimi mbi pushimin e marrëdhënies së punës i dt.17.05.2011.


Nuk është kontestuese se paditësi ka ndërruar jetë me datë: 17.07.2012, pasi ky fakt vërtëtohet nga certifikata mbi vdekjen.

Se është shpall trashëgimtar ligjor kjo vërtëtohet përmes aktvendimit mbi tashëgiminë, pastaj se i njëjti ka shprehur interesimin e tij për vazhdimin e procedurës, kjo vërtëtohet përmes parashtrësës së datës: 01.07.2013.

Këto janë faktet e provuara me prova të cilat nuk janë kontestuese për palët ndërgjyqëse. Kontestuese mbetet qështja e pagesës së të ardhurave personale, si dhe të ardhurave tjera si paga përcjellëse dhe shpërblimi jubilar.

Paditësi përmes të autorizuarit të tij pretendon se marrëdhënia e punës e cila i është ndërprerë me datë: 17.05.2011 i është dashur t'i vazhdohet deri në muajin shtator duke përfshirë muajt, qershor, korrik dhe gusht. Këtë pretendim i autorizuari paditësit e bazon në Udhëzimin Administrativ 01/2010 të dt.30.03.2010 neni 2.

Sipas nenit 2 të Udhëzimit Administrativ 01/2010 thuhet citoi: " Për mësimdhënësit të cilët i plotësojnë kushtet për pensionim pas fillimit të vitit akademik përkatësisht shkollor, nuk zbatohen dispozitat e urdhërësës administrative nr.2003/2 mbi zbatimin e rregullores së UNMIK-ut 2001/36 mbi shërbimin civil të Kosovës dhe Udhëzimit Administrativ nr.18/2005." Ky nen shfuqizon më konkretisht nenin Për mësimdhënësit të cilët plotësojnë kushtet për pensionim, pas fillimit të vitit akademik përkatësisht shkollor, nuk zbatohet dispozita ligjore e nenit 1.1 në momentin e mbushjes së moshës gjashtëdhjetë e pesë vjet (65) por u vazhdohet kontrata e punës deri në fund të vitit akademik përkatësisht shkollor.



Sipas interpretimit të gjykatës është pikërisht neni 2 i Udhëzimit Administrativ 01/2010 që e shfuqizon vazhdimin e kontrates edhe pas arritjes së moshës 65 vjeçare deri në përfundimin e vitit shkollor apo akademik, ndërsa vazhdimi i kontratës tash e tutje vlen vetëm për shërbyesit civil. Në kategorinë e shërbyesve civil nuk hyjnë kategoritë e masimdhënësve krejt kjo sipas nenit 4 pika 1 të Ligjit Për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës i cili është në fuqi që nga data: 14.06.2010 ku thuhet se kategoritë e punonjësve publick të cilët nuk janë pjesë e shërbimit civil në rend të parë përmendët stafi mësimorë i sistemit arsimor.

Sa i përket pjesës tjetër të kërkespadiës në lidhje me pagat përcjellëse dhe shpërblimit jubilar, gjykata konsideron se një kërkesë e tillë është e **PA BAZUAR** për këto arsye: Kontrata Kolektive ka hyrë në fuqi në vitin 2005, ndërsa në nenin 90 pika 4 thuhet citoi: " Marrëveshja Kolektive mund të lidhet për një periudhë të caktuar me kohëzgjatje jo më shumë se tri (3) vjet." Në bazë të kësaj gjykata konsideron se marrëveshja apo kontrata kolektive nuk është më valide pasi në vitin 2008 ajo pushon së prodhuari efekt juridik sipas fuqisë ligjore, dhe se e njëjta nuk është më në fuqi, e poashtu gjykata nuk është në dëgjim për përtrijen e saj.

Andaj duke u bazuar në të lartë cekurat bazen ligjore të theksuar me lartë interpretimin e saj nga ana e gjykatës, arrijmë në përfundim se kërkespadija e paditësit duhet të refuzohet në tërësi si e **PA BAZUAR**.

Me sa u tha me lartë e në bazë të nenit 143 të LPK, u vendos si në diapozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
C.nr.150/2012 Datë: 16.09.2013



GJYQTARI
Faton Ademi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi lejohet ankesa në afat prej 15 dite nga data e pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet kësaj gjykate.

*atp. të autoriz. të praritës
te praritës*

16.9.2013